



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.48/2018
Prishtinë, më 20.11.2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Glauk Konjufca, Hykmete Bajrami, Lutfi Zharku, Memli Krasniqi, Muharrem Nitaj, Veton Berisha dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Liburn Aliu, anëtar.

I ftuar: z. Endrit Shala, ministër i Tregtisë dhe Industrisë (MTI).

Pjesëmarrës tjerë: Durim Limaj, Rexhep Bllaca, MTI; Vatra Qehaja, LVV; Edon Baliqi, KDI; Dren Ajeti, Klubi i Prodhuesve, si dhe mediat.

Stafi mbështetës i komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 6.11.2018;
3. Raportim i ministrit për Tregti dhe Industri, z. Endrit Shala, lidhur me realizimin e planit të punës së këtij viti dhe planifikimet për vitin e ardhshëm;
4. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 6.11.2018

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 6.11.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Raportim i ministrit për Tregti dhe Industri, z. Endrit Shala, lidhur me realizimin e planit të punës së këtij viti dhe planifikimet për vitin e ardhshëm

Kryetarja, theksoi se sot në raportim e kemi ministrin e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, për të raportuar lidhur me realizimin e planit të punës për vitin 2018, si dhe planifikimin për vitin e ardhshëm. Ajo njoftoi deputetët se ministri e ka dërguar një raport me shkrim dhe ia dha fjalën ministrit, që të bëjë prezantimin e punës së ministrisë.

Endrit Shala, ministër i Tregtisë dhe Industrisë, fillimisht falënderoi deputetët për ftesën dhe bashkëpunimin e deritanishëm me ministrinë. Ai theksoi se raportin e punës së ministrisë e kemi dërguar dhe tani do ta paraqesë para juve. Duke folur për punën e ministrisë, ministri Shala sqaroi për deputetët se sa i përket legjislacionit gjatë periudhës raportuese, janë miratuar 7 ligje, 14 udhëzime administrative dhe 6 rregullore, si dhe janë miratuar nga Qeveria 4 udhëzime administrative dhe 1 rregullore, të cilat janë sponsoruar nga MTI-ja. Ai, në vazhdim, foli për përkrahjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, përmes lehtësimit të qasjes në financa dhe përmirësimit të standardeve të cilësisë, ku theksoi se Fondi Kosovar për Garanci Kreditore deri tani ka garantuar mbi 1500 kredi. Në vazhdim, z. Shala foli për rritjen e nivelit të investimeve të huaja direkte dhe atyre të diasporës; për avancimin e politikave industriale të Kosovës; për turizmin; për përmirësimin e mbikëqyrjes së tregut, përmes kontrolleve të rregullta të tregut dhe promovimit të të drejtave të konsumatorit; për zhvillimin e mëtejshëm të politikave tregtare, duke përmirësuar kornizën legjislative, si dhe ngritjen e kapaciteteve të dikastereve relevante; për përmirësimin e shërbimeve të pronësisë industriale, përmes promovimit të rëndësisë që ka pronësia industriale e bizneset dhe ngritjen e kapaciteteve të institucioneve relevante; për integrimin evropian dhe koordinimin e politikave; si dhe për planin e punës të ministrisë për vitin e ardhshëm.

Muharrem Nitaj, theksoi se pas taksës për produktet e Serbisë, morëm lajmin se është rritur çmimi i bukës në disa lokacione. A keni ndonjë analizë pse është rritur çmimi i bukës? Po ashtu, pyeti se a ekziston instrumenti për kontrollimin e mallrave nga Serbia, pasi që duhet dalluar se a janë brende të Serbisë apo ndërkombëtare?

Ministri sqaroi se Kosova mbulon 80% nevojat e saj me grurë. Rritja e çmimit të bukës nuk ka të bëjë me taksën për importin nga Serbia. Rritja e çmimit të bukës është bërë në Prizren dhe Kaçanik dhe mendohet se për këtë rritje janë marrë vesh vetë furrtarët dhe këtë mund ta kontrollojë Autoriteti i Konkurrencës nëse ka abuzim, të cilin autoritet e kemi njoftuar.

Dardan Sejdiu, theksoi se tregtinë me jashtë duhet trajtuar si politikë të jashtme. Taksa prej 10% është e mirëseardhur, por jo e mjaftueshme. Ekziston disbalanc i madh ndërmjet eksportit dhe importit, prandaj duhet kodifikimi i tregtisë së brendshme dhe të tregtisë së jashtme. Këto dy ligje duhet t'i kemi sa më shpejt dhe të ecim përpara. Nuk shoh në raport ndonjë gjë konkrete për zhvillim të industrisë. Fokusi duhet të jetë si ta luftojmë këtë disbalanc tregtar. Çka do të ndodhë pas taksës 10%? Cili është hapi konkret? A ka ndonjë veprim vazhdues? Kur do ta miratoni udhëzimin administrativ për vendosjen e flamujve të vendit të origjinës së produktit nëpër markete, pranë produktit, në mënyrë që konsumatorët të dinë se çfarë produkti do të blejnë dhe a do të hyjë në fuqi ky udhëzim për fund vit?

Glauk Konjufca, potencoi se defektet në ekonomi vijnë nga orientimet ekonomike. Qeveria me Ligjin për buxhetin për 2019, parasheh rritje të të hyrave nga importi. Si mendoni t'i zëvendësoni importet, pasi që rreth 90% kemi import, ndërsa rreth 10% eksport? Nuk po shohim nga Qeveria plan për përmirësimin e këtij disbalanci. Investitorët nga diaspora kanë vërejtje se nuk po kanë trajtim të veçantë për investim në Kosovë. Sa është investimi i diasporës në Kosovë? Si është krahasimi vit pas viti? Pra, të kemi informacion më të saktë. Janë dy laboratorë testues të derivateve, por mendoj se duhet të tregohen edhe emrat që të dihet kush janë ata laboratorë.

Hykmete Bajrami, theksoi se ka rënie në ranglistën e të bërit biznes. Nuk po shohim pjesëmarrje në Këshillin për Zhvillim Ekonomik. Inspektorati nuk po ka progres. Sa e keni ndihmuar Fondin për Garanci Kreditorë? Sepse fondi duhet që, me buxhetin e vet, të vazhdojë funksionimin. I keni disa agjenci të ministrisë, me ushtrues detyre, të papërgatitur, pse janë ende me ushtrues detyre? Kemi pasur rënie drastike të investimeve të huaja direkte. Ligji për shoqëritë tregtare, veçanërisht kuota gjinore në borde, si po ndikon te bizneset, sepse kemi konsideruar se është barrë për bizneset? Për zonat ekonomike, kush i përzgjedh operatorët ekonomikë, komunat apo ministria? Inkubatori i biznesit në parkun e Drenasit, i zbrazët, si po mendoni të hapni edhe inkubatorë të tjerë, siç është rasti në Malishevë, kur ky në Drenas nuk po funksionon? Vendimin e mëparshëm për taksën 30% për pemë edhe perime, e keni mbajtur në fuqi vetëm një javë, për këtë duhen taksa të qëndrueshme. Kemi informata se MTI, garancinë bankare të inkuaruar për projektin e Brezovicës po provon ta kthejë, kjo është shkelje. Çka po ndodh me këtë çështje? Nga ministri i mëparshëm ishte shkarkuar sekretari i ministrisë, por mandej është shkarkuar ministri, ndërsa është kthyer sekretari. Kush ka bërë shkelje prej tyre?

Memli Krasniqi, theksoi se në këtë periudhë janë marrë disa vendime të rëndësishme. Taksa prej 10% , vendim i drejtë i Qeverisë. Ndonjë tregtar mund ta keqpërdor këtë taksë dhe të ngre çmimet, por nuk ka arsye të rritet çmimi i bukës. Të merren masa në kuptimin legal, për ata që abuzojnë. Keni bërë punë të mirë, sa i përket lodrave për fëmijë, me efekte negative për fëmijët. Lidhur me afatet e produkteve që konsumohen duhet të shtohet kontrolli, të dënohen dhe të disiplinohen tregtarët që falsifikojnë afatin e skadimit për produkte. A mund të vendosni kufizime në import, të ndërlihdura me afatin e skadimit, sepse ka produkte që hyjnë pak para se t'iu skadojë afati i konsumimit? U përmend se ka disbalanc tregtar, por na tregoni se cilët sektorë kanë bilanc pozitiv? Lidhur me KIESA-n, cilat janë kërkesat e juaja për buxhet, që lidhen me promovimin e investimeve në Kosovë? Ekzekutimi i garancisë për Brezovicën ka ndodhur dhe çfarëdo vendimi për kthim është shkelje ligjore. Të shikoni rritjen e taksës nga 10% në 25%, sepse Serbia po lobon kundër Kosovës, në të gjitha aspektet.

Veton Berisha, theksoi se taksa prej 10% është masë e mirëseardhur. Gjatë diskutimeve me biznese, kemi kuptuar se prodhuesit vendorë po kanë vështirësi në futjen e produkteve në treg, sepse disa markete nuk po u krijojnë hapësirë, prandaj duhet të punoni që të krijohet hapësira për prodhimet vendore. Rritja e çmimit të bukës është shqetësuese, prandaj duhet të analizohen pse u rrit çmimi i bukës dhe për komunitetin që përfaqësoj, është shumë e ndjeshme kjo rritje. Nuk kemi parë një program të ministrisë, që ka ndonjë politikë për komunitetet, sa i përket granteve. Komunitetet kanë vështirësi në zhvillim dhe si mendoni të mbështetni minoritetet, sidomos minoritetin që unë përfaqësoj?

Kryetarja, pyeti: Pse nuk është arritur të funksionalizohet inkubatori i bizneseve në Parkun Industrial në Drenas? Fillimisht, duhet të funksionalizohen ato që janë hapur e mandej të mendohet për hapjen e inkubatorëve tjerë, edhe të ndryshohet ndonjë gjë, nëse nevojitet, bazuar në përvojën me inkubatorë të mëparshëm. Inspektorati të kontrollojë, nëse po keqpërdoret nga tregtarët vendosja e taksës në importe nga Serbia prej 10%.

Ministri, duke u përgjigjur në pyetjet e deputetëve, sqaroi se mundësia jonë është që çështjet tregtare t'i rregullojmë me Ligjin për tregtinë e brendshme dhe të jashtme. Lidhur me disbalancin tregtar, kam kërkuar që të identifikohen fushat ku ne të mund të ndihmojmë me grante, aty ku mund të rritet eksporti. Pas taksës prej 10%, si masë, mund të vazhdojë edhe reciprociteti me Serbinë. Udhëzimi Administrativ për vendosjen e flamujve të vendit të origjinës së produktit, do të hyjë në fuqi më 22 dhjetor. Lidhur me diasporën, fokusi ynë ka qenë promovimi i mundësive për investimeve në Kosovë nga diaspora. Ata kanë hasur në sfida ligjore që të kualifikohen si investitorë strategjikë, si dhe kategorizimi i vlerës së investimeve është kërkuar të ulët. Ky kategorizim mund të ndryshohet vetëm me ndryshimin e Ligjit për investimet strategjike. Sfidë për diasporën ka qenë edhe garancia bankare me rastin e aplikimit për investime strategjike. Në bazë të raporteve, rënia në ranglistën e të bërit biznes ka ndodhur, për shkak se disa vende kanë ecur më shumë përpara. Lidhur me industrinë kemi një projekt të Bankës Botërore, ku po ndërtohet lokacioni i ri në Bërnice dhe komplet qendrën e kualitetit në Kosovë do ta dislokojmë atje. Lidhur me inspektoratin, në kuadër të Qeverisë, është duke u zhvilluar projekti për inspektoratin, në përgjithësi, sesi do të funksionojë. Sa i përket granteve prej 329 aplikues, kanë përfituar 18 aplikues, ndërsa janë ankuar vetëm 12 aplikues. Ushtrues detyre të drejtorit apo kryeshefit, për momentin, është vetëm në KIESA. Lidhur me garancinë bankare për Brezovicën, ka qenë një kërkesë nga kompania për lirim nga garancia, por për neve kjo çështje është e mbyllur. Ministri i mëparshëm e ka suspenduar sekretarin për 30 ditë, por nuk e ka shkarkuar. Unë jam i kënaqur me punën e sekretarit. Zëvendësimi i ministrit është politikë e NISMA-s. Për zonat ekonomike, tash procedurat e prokurimit i udhëheq ministria, sipas marrëveshjeve mes MTI-së dhe komunave. Inkubatori për Malishevë ka qenë kërkesë e Komunës së Malishevës. Sektorët që kanë disbalanc pozitiv tregtar, janë vera, druri, IT, mineralet dhe shërbimet. KIESA ka buxhet 5 milionë euro, por do të ishte e mirëseardhur të ketë rritje, në mënyrë që të promovohen sa më shumë mundësitë për investime. Lidhur me lodrat, kemi mbajtur takim me të gjitha inspektoratet edhe me inspektorë të komunave për bashkërendim të inspektimeve për identifikim dhe ndalim të lodrave me përmbajtje të dëmshme, janë asgjësuar një numër i madh, do të bëjmë edhe inspektimin e lodrave që përdoren nëpër çerdhe. Fokusi në lodra do të vazhdojë. Sa i përket afateve të skadimit gjatë importit, këtë çështje do ta trajtojmë me Ligjin për tregtinë e brendshme dhe të shohim alternativat sesi ta

rregullojmë. Inspektimet në treg janë shtuar, që të sigurohemi se produktet janë cilësore në treg. Në media është publikuar se në deklaracion të produkteve, shkruan emërtim ndryshe për Kosovën nga ai që është në Kushtetutë. Ne kemi lëshuar urdhëresë që kudo që gjenden në treg produkte me deklaracion të tillë të largohen nga tregu, po ashtu edhe në doganë të ndalohen të hyjnë produkte me deklaracion të tillë. Mbështetja për produktet vendore do të adresohen me Ligjin për tregtinë e brendshme. Lidhur me pyetjen për grante për komunitete të caktuara, deri tash, nuk ka pasur grante me kuotë për komunitete të caktuara, por do të shohim nëse kemi mundësi ligjore që grante të caktuara, të ndahen për komunitete më pak të zhvilluara. Inkubatori në Parkun Industrial në Drenas nuk është funksionalizuar, sepse nuk ka pasur të interesuar, ka qenë vetëm një i interesuar, i cili nuk ka plotësuar kushtet. Në të ardhmen, parashihet që të ndërtohet edhe parku industrial tjetër në Drenas, në anën tjetër të rrugës, ku është parku industrial ekzistues.

Hykmete Bajrami, theksoi se me udhëzimin administrativ për naftën, qëllimi ka qenë që të ndërtohet një laborator shtetëror, që do të matë 18 faktorë të naftës. Ku jeni me ndërtimin e këtij laboratorit? E kam parë në ueb faqe se janë akredituar 10 trupa për produkte të ndërtimit, si janë akredituar? A ka ndonjë biznes që është kualifikuar si investitor strategjik? Çka ka ndodhur me lodrat jo në rregull? Cili është numri i saktë i personelit me kontratë në vepër?

Memli Krasniqi, potencoi se është mirë që mos të lihen që të hyjnë në doganë produktet me emërtime jokushtetuese në deklaracion. Të shikoni, nëse është i nevojshëm edhe vendimi i Qeverisë për ndalimin në doganë të produkteve me emërtime jokushtetuese në deklaracion të produktit.

Ministri sqaroi se urdhëresën për ndalimin e produkteve me emërtime jokushtetuese në deklaracion e kam marrë dje dhe është i bazuar në Ligjin për mbrojtjen e konsumatorit. Janë të obliguara ta zbatojnë të gjitha institucionet. MTI nuk ka paraparë buxhet për ndërtim të laboratorit për naftë. Aktualisht, dogana bën analiza tarifore se çfarë kategorie e derivateve është. Janë dy laboratorë të licencuar. Mendojmë që disa shërbime të kryhen përmes partneritetit publiko-privat. Janë asgjësuar rreth 17 mijë lodra, është kërkuar që dogana mos të lejojë importin e lodrave pa shenjën “CE”.

Glauk Konjufca, potencoi se në një medium është publikuar se ministria ka ndërhyrë në kriteret e konkursit për inspektor të cilësisë për naftë, duke i ndryshuar dhe përshtatur ato për kandidatë të caktuar.

Ministri u përgjigj se për këtë çështje nuk kam informacion dhe do të informohem se çka ka ndodhur me këtë çështje.

Pas debatit, komisioni nxori këtë:

Përfundim

Komisioni do ta përkrahë Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, në shqyrtimin e projektligjeve për tregtinë e brendshme dhe të jashtme; në ndërmarrjen e masave që mbrojnë, mbështesin dhe promovojnë prodhimin vendor dhe rrisin eksportin, si dhe kontrollin e tregut, në mënyrë që të sigurohet konsumatori për cilësinë e produktit, dhe njëkohësisht, do të bëjë kontrollin demokratik përmes raportimit për secilën çështje.

4. Të ndryshme
Çështjet vijuese.

Kryetarja kërkoi nga anëtarët e komisionit, që të vizitohet KOSTT-i, në mënyrë që të marrim informacionet e sakta për situatën aktuale rreth anëtarësimit të KOSTT-it në ENTSO-E.

Komisioni përkrahu kryetaren.

Kryetarja i njoftoi deputetët se e kemi në procedurë rekrutimin e anëtarëve të Bordit të KOSTT-it dhe duhet të vendosim për panelin e intervistimit, në bazë të këshillës juridike të sekretarit të Kuvendit dhe projektit të ambasadës britanike.

Komisioni, në mbledhjen e radhës do të vendosë për panelin e intervistimit të kandidatëve për anëtarë të bordit të KOSTT-it.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti: Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Sala BERISHA SHALA